

Aneksi nr. 3

Struktura e Pyetësorit të Censit të Popullsisë dhe Banesave, sipas moduleve

Moduli 1: Informacion mbi Ndërtesën

| Koncepti | Përkufizimi | Pyetje në modul |
|---|--|---|
| Ndërtesa: Ndërtesat të cilat nuk janë të dizenuara për banim dhe që nuk banohen, nuk janë objekt i censit dhe për to nuk mblidhet asnjë informacion | Një ndërtesë përcaktohet si një strukturë e pavarur që përmban një ose më shumë banesa, dhoma ose hapësira të tjera, e mbuluar nga një çati dhe e rrethuar me mure të jashtme ose mure ndarëse që zgjaten nga themelet deri në çati, e dizenuar për qëllime banimi, bujqësore, tregëtie, industriale, kulturore ose për sigurim shërbimesh. Kështu, një ndërtesë mund të jetë një shtëpi e veçuar, një pallat, një fabrikë, dyqan, magazinë, garazhd, etj. | Lloji i ndërtesës Materiali i ndërtimit Viti i ndërtimit të ndërtesës |

Moduli 2 - Informacion mbi Banesën

| Koncepti | Përkufizimi | Pyetje në modul |
|-----------------------------|---|--|
| Banesë e zakonshme: | Një banesë e zakonshme përcaktohet si një dhomë e pavarur ose bashkësi dhomash dhe aksesorët e tyre (si psh. hollet, korridorët) në një ndërtesë të qëndrueshme ose strukturë e ndarë, që është ndërtuar, rindërtuar ose shndërruar, e dizenuar për banim gjatë gjithë vitit. Shtëpitë ose apartamentet janë një shembull për këto banesa. | Lloji i banesës Pronësia e Banesës Statusi i banimit Statusi i banesës së pabanuar Informacion mbi adresën zyrtare Sistemi kryesor i furnizimit me ujë Tualeti Dush/Vaskë |
| Banesë jo zakonshme: | Disa njësi banimi që nuk bien plotësisht në kategorinë e “banesave të zakonshme”, pasi ato mund të jenë të lëvizshme, gjysëm të lëvizshme ose të improvizuara, ose që nuk janë të dizenuara për banim njerëzor të qëndrueshëm, por që pavarësisht këtyre po përdoren në Momentin e censit. Nëse një banesë e zakonshme është e banuar në Momentin e censit ajo do të përfshihet në cens. | Rrjet i energjisë elektrike Sistemi i ngrohjes Lloji kryesor i energjisë për ngrohje Sipërfaqja e banimit në përdorim Numri i NjEF-së |
| Banesa kolektive: | Kjo kategori përmban ndërtesa të cilat janë dizenuara për banim nga një grup i gjerë individësh dhe që përgjithësisht përdoren si vendbanim i zakonshëm nga të paktën një person në Momentin e censit. Grupi i personave të cilët jo domosdoshmërisht janë të lidhur me lidhje martesë, gjaku, adoptimi ose kujdesje, jetojnë së bashku për qëllime shkollimi, shëndetësore, kryejrje krimesh, ndihmë sociale, etj. Për qëllime të censit këto banesa do të numërohen nga anketues të veçantë, të cilët do të përdorin pyetësorë për këto banesa kolektive. Banesat e mëposhtme përfshihen në banesat kolektive: hotele, burgje, spitale, jetimore, azile, manastire, | |

konvikte, kampe.

Moduli 3 - Informacion i NjEF

| Koncepti | Përkufizimi | Pyetje në modul |
|----------------------------|---|---|
| Njësi Ekonomike Familjare: | Për qëllime të censit, një njësi ekonomike familjare i referohet një grupi personash të cilët banojnë sëbashku në një banesë dhe që ndajnë një ekonomi pjesërisht ose plotësisht të përbashkët. | Statusi i pronësisë Pajisjet shtëpiake |

Moduli 4 - Informacion mbi Bujqësinë

| Koncepti | Përkufizimi | Pyetje në modul |
|-----------------|--|--|
| Tokë Bujqësore: | Tokën e punëshme të përdorura nga familja juaj në 12 muajt e fundit qoftë në pronësi, me qira ose në përdorim- në territorin e Shqipërisë. | Tokë Bujqësore Tokë e punëshme - sipërfaqja Drufrutorët - sipërfaqja Livadhe dhe Kullota - sipërfaqja Blegtori ose Bletë Numri i Gjdhëve Numri i të Leshtave Numri i të Dhirtave Numri i Derrave Numri i Shpendëve Numri i Njëthundrakëve Numri i Bletëve |

Moduli 5 - Lista e NjEF

| Koncepti | Përkufizimi | Pyetje në modul |
|-----------------------|---|--|
| Personi i referencës: | Është anëtari i njësisë ekonomike familjare, i cili merr zakonisht vendimet kryesore në këtë njësi ekonomike familjare dhe që njihet si i tillë nga anëtarët e tjerë të njësisë ekonomike familjare. Në shumë raste, në një njësi ekonomike familjare me një çift me fëmijë të pamartuar, babai njihet si personi i referencës. | Emri Mbiemri Gjinia Lidhja me personin e referencës Datëlindja Moshë Statusi ligjor martesor |

Moduli 6 - Informacioni individual

| Koncepti | Përkufizimi | Pyetje në modul |
|-----------------------|--|---|
| Vendbanues zakonshëm: | Vendbanuesit e zakonshëm janë të gjithë personat të cilët janë banues të zakonshëm në Shqipëri, pavarësisht shtetësisë së tyre ose nëse janë ose joprezent në vendbanimin e zakonshëm në | Bashkëjetesë Bashkëshort/e ose partner/e Atësia |

| | | |
|--|--|---|
| | Momentin e censit ose përkohësisht në mungesë (me kusht që kjo mungesë të mos jetë më shumë se 12 muaj). | Amësia Vendlindja Shtetësia |
| Personat përkohësisht në mungesë: | Këta janë personat të cilët janë rezident të zakonshëm në vendin e numërimit, por të cilët kanë qenë në mungesë për më pak se 12 muaj në Momentin e censit. Të gjithë personat përkohësisht në mungesë duhet të përfshihen në numërim në njësinë ekonomike familjare ku ata janë rezident të zakonshëm. | Adresa e njëjtë në natën e Censit Arsyeja kryesore e mungesës në natën e Censit Vendbanimit të zakonshëm në 2011 Lëvizur që prej 2011 Vendbanimi i zakonshëm i mëparshëm Koha kur ka ardhur në Shqipëri Arsyeja kryesore e ndryshimit të vendbanimit |
| Momenti i censit: | Mesnata e natës para Ditës së censit, E premte 30 Shtator/ E shtunë 1 Tetor 2022. Ky moment do të jetë pikë kritike në kohë për të përcaktuar kush do të përfshihet në numërim. Të gjithë personat prezent në Momentin e censit duhet të numërohen. Çdo person i cili ka vdekur pas Momentit të censit duhet të përfshihet në numërim duke qenë se ata kanë qenë gjallë në mesnatë. Fëmijët e lindur pas Momentit të censit nuk duhet të përfshihen. | Keni jetuar ndonjëherë jashtë shtetit Shteti i vendbanimit të zakonshëm të mëparshëm Koha e ardhjes Arsyeja e ardhjes |
| Arsimi zyrtar: | I referohet programit të rregullt arsimor të ofruar nga tërësia e sistemit të institucioneve arsimore që ushtrojnë aktivitetin e mësimdhënies, ligjërisht, në mënyrë të vazhduar (kryesisht), të shkallëzuar dhe për grup moshë të caktuara (teorikisht). | Duke ndjekur çerdhe Duke ndjekur kopësht apo parashkollor Shkrim dhe lexim Duke ndjekur arsimin zyrtar Ndjekur ndonjëherë arsim zyrtar Niveli i arritur i arsimit zyrtar |
| Forca e Punës: | Përfshin personat e punësuar dhe të papunë. | Punësimi |
| Popullsia në moshë pune: | Është popullsia 15-64 vjeç | Mungesa në punë |
| I punësuar me pagë: | Konsiderohet si i punësuar kundrejt pagës çdo person që punon për një punëdhënës publik ose privat dhe që merr kompensim në formën e pagës, pagesës mbi bazën e rezultateve ose pagesës në natyrë. Normalisht, një i punësuar me pagë punon për një punëdhënës jo të familjes së tij/saj. | Punë në bujqësi Prodhimi Bujqësor Kërkimi i punës Gatishmëria për punë Arsyeja pse nuk ka kërkuar punë Statusi i punësimit Orët e punës Profesioni Emri i organizatës/ndërmarrjes Vendndodhja e punës Shpeshtësia e udhëtimit Lloji i transportit Kohëzgjatja e udhëtimit drejt vendit të punës |
| | | Fëmijë të lindur gjallë Numri i fëmijëve të lindur gjallë Numri i fëmijëve që jetojnë |
| Deklarim i lirë /Vet-identifikim | Pyetjet mbi identitetin etnik, besimin fetar dhe gjuhën, sipas ligjit të Cens, përgjigjet e këtyre pyetjeve bazohen në parimin e 'vet-identifikimit'. Për këto pyetje të përgjigjurit mund të zgjedhin alternativën 'Preferoj të mos përgjigjem' | |
| Identiteti etnik: | I referohet një kuptimi të përbashkët të origjinës historike dhe territoriale (rajonale, kombëtare) të një grupi etnik ose komuniteti si dhe karakteristikave të veçanta kulturore: gjuha | Identiteti etnik Besimi Fetar Gjuha |

| | | |
|---------------------------|--|---|
| | dhe/ose feja dhe/ose zakone specifike dhe mënyra e jetës. | |
| Aftësia e Kufizuar | Pyetjet mbi aftësinë e kufizuar përfshin pyetje në lidhje me gjastë lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara: vështirësi me shikim, dëgjim, ecje apo ngjitje shkallësh, në të mësuar apo në përqendrim ose në të mbajturit mend, në komunikim dhe në kujdesin e përditshëm ndaj vetes. | Vështirësi në shikim Vështirësi në dëgjim Vështirësi në ecje, ngjitje shkallësh |
| Aftësia e Kufizuar | Pyetjet mbi aftësinë e kufizuar përfshin pyetje në lidhje me gjastë lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara: vështirësi me shikim, dëgjim, ecje apo ngjitje shkallësh, në të mësuar apo në përqendrim ose në të mbajturit mend, në komunikim dhe në kujdesin e përditshëm ndaj vetes. | Vështirësi në të mësuar, në përqendrim, në të mbajturit mend Vështirësi në kujdesin e përditshëm ndaj vetes Vështirësi në komunikim |
| | | Numri identitetit ID |

Moduli 7 - Lista e anëtarëve të mëparshëm

| Koncepti | Përkufizimi | Pyetje në modul |
|---------------------------------------|--|---|
| Anëtarët e mëparshëm NjEF-së : | Të gjithë personat të cilët kanë qenë anëtarë të mëparshëm të kësaj NjEF-je në këtë adresë gjatë 10 viteve të fundit, por që tani jetojnë jashtë vendit dhe: kanë jetuar jashtë vendit për një periudhë prej 12 muaj apo më shumë ose kanë qëllim të jetojnë jashtë vendit për 12 muaj apo më shumë. | A ka anëtarë të mëparshëm NjEF-ja Emri i anëtarit të mëparshëm të NjEF-së Mbiemri i anëtarit të mëparshëm të NjEF-së Datëlindja e anëtarit të mëparshëm të NjEF-së Gjinia e anëtarit të mëparshëm Shtetësia e anëtarit të mëparshëm Shteti i vendbanimit i anëtarit të mëparshëm Viti i largimit Arsyet e largimit A ka anëtarë tjetër të mëparshëm të NjEF-së |

Moduli 8 - Lista e Vizitorëve

| Koncepti | Përkufizimi | Pyetje në modul |
|---|--|---|
| Vizitorët Personat përkohësisht prezent: | Këta janë personat të cilët po e vizitojnë përkohësisht njësinë ekonomike familjare që po numërohet dhe që janë prezent aty në Momentin e censit. Duke qenë se ata janë rezident të zakonshëm në një njësi ekonomike familjare tjetër, ata do të numërohen diku tjetër. Ata do të përfshihen në një listë të veçantë për vizitorët në njësinë ekonomike familjare ku ata gjenden në Momentin e censit. | A ka pasur vizitorë Emri i vizitorit Mbiemri i vizitorit Datëlindja e vizitorit Gjinia e vizitorit Kërko për Letërnjoftim ID të vizitorit Numri i ID-së së vizitorit Atësia e vizitorit Amësia e vizitorit Shteti i vendbanimit të vizitorit Bashkia e vendbanimit të zakonshëm Qyteti/fshati i vendbanimit të zakonshëm |